

Rezultatet e anketës së vlerësimit të stafit akademik për institucionin për vitin akademik 2023-2024

Për vitin akademik 2023-2024, numri i pjesëmarrësve në anketë është 37 anëtarë të stafit akademik. Vlerësimi më poshtë është bërë në bazë të katër (4) seksioneve me pohime të organizuara sipas shkallës Likert, dhe një (1) seksioni me sugjerime.

A. Shërbimet e ofruara në institucion

Pyetja 1 Në lidhje me kushtet e hapësirave që ofron institucioni, 67.5% e pjesëmarrësve shprehen se janë plotësisht të kënaqur me ambientin, 27% janë pjesërisht të kënaqur dhe 5.4% janë të pakënaqur ose aspak të kënaqur me mjediset që ofron institucioni.

Pyetja 2 Për 81.1% të anëtarëve të stafit akademik, kushtet higjieno-sanitare janë të kënaqshme ose plotësisht të kënaqshme, 10.8% e pjesëmarrësve janë pjesërisht dakord se kushtet janë të kënaqshme, 8.1% e pjesëmarrësve shprehin pakënaqësi me kushtet higjieno-sanitare.

Pyetja 3 Për sa i përket sigurisë në institucion, 78.3% e stafit janë dakord ose plotësisht dakord se kushtet e sigurisë në institucion janë të kënaqshme, 16.2% janë pjesërisht dakord dhe 5.4% nuk janë dakord ose aspak dakord.

Pyetja 4 Në lidhje me shërbimet teknologjike që ofrohen në institucion, ndërkohë që 48.6% mendojnë se janë në nivele të kënaqshme, 32.4% mendojnë se shërbimet teknologjike janë pjesërisht në nivele të kënaqshme dhe 18.9 nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë mendim.

Pyetja 5 Për sa i përket sistemit informativ BIS, ai është në nivele plotësisht të kënaqshme ose të kënaqshme përkatësisht për 27% dhe 29.7%, në mënyrë të pjesshme për 40.5% të pjesëmarrësve, dhe 2.7% e tyre nuk janë dakord me këtë pohim.

Pyetjet 6-7 75.6% e stafit mendojnë se janë të informuar në lidhje me zhvillimet në institucion dhe 16.2% mendojnë se informimi është i pjesshëm, 8.1% mendojnë se nuk janë të informuar. Për sa i takon kohës së informimit, 62.1 % mendojnë se informimi bëhet në kohë, 21.6% janë të mendimit se informimi bëhet pjesërisht në kohën e duhur, dhe 16.2% shprehen se informimi nuk bëhet gjithmonë në kohën e duhur.

Pyetjet 8-10 Për sa i përket shërbimit të bibliotekës, 72.9% janë të kënaqur, 21.6% janë pjesërisht të kënaqur. Ndërkohë, në lidhje me literaturën, vetëm 24.3% e anëtarëve të stafit akademik mendojnë se mund ta gjejnë në bibliotekë literaturën e nevojshme, pjesa tjetër mendojnë se e gjejnë pjesërisht (40.5%), dhe 35.1% e tyre mendojnë se nuk e gjejnë literaturën e nevojshme.

51.3% e pjesëmarrësve e përdorin gjithmonë ose shpesh JStore për nevojat akademike dhe kërkimore, 32.4% e përdorin ndonjëherë dhe 16.2% e përdorin rrallë.

Pyetja 11 72.9% e pjesëmarrësve janë të kënaqur me ushqimin e ofruar, 21.6% janë pjesërisht të kënaqur dhe 5.4% nuk janë të kënaqur me këtë shërbim.

Si përfundim, pjesa më e madhe e stafit është në përgjithësi e kënaqur me shërbimet e ofruara, kryesisht me sigurinë në institucion dhe informimin mbi aktivitetet që organizohen.

Për sa i përket shërbimit të bibliotekës dhe gjendjes së literaturës së nevojshme, vihet re se pak më shumë se një e katërta e stafit e gjen literaturën e nevojshme në bibliotekë dhe pjesa dërrmuese luhet midis e gjen pjesërisht, rrallë ose fare. Kjo pikë duhet marrë në konsideratë për përmirësim duke punuar për shtimin e literaturës përkatëse për çdo program studimi në bibliotekë.

Në lidhje me shërbimet e teknologjisë, më pak se 50% e stafit shprehen të kënaqur me këtë shërbim, ndërkohë që pjesa tjetër shpreh pakënaqësi të pjesshme në nivele të ndryshme. Edhe sistemi i informimit BIS është një pikë për të cilën stafi ka kërkuar rishikim. Kjo mbështetet edhe me pikën e fundit të anketës ku disa anëtarë shprehen për nevojë të domosdoshme të përditësimit të teknologjisë në institucion si dhe të sistemit informativ BIS duke e lidhur atë me shërbime të tjera me qëllim lehtësimin e proceseve të ndryshme të informimit dhe publikimit.

Nuk ka asnjë shërbim ndaj të cilit të ketë pakënaqësi totale.

B. Bashkëpunimi në departament dhe në institucion

Pyetja 12 Në lidhje me bashkëpunimin në institucion rezulton se pjesëmarrësit janë plotësisht të kënaqur (37.8%) ose të kënaqur (27%), 29.7% janë pjesërisht dakord dhe 5.4% nuk janë dakord me mendimin se ka bashkëpunim mes stafit akademik dhe atij administrativ në institucion.

Pyetja 13 Në lidhje me bashkëpunimin me koordinatore të departamentit, 83.8% e pjesëmarrësve shprehen të kënaqur dhe plotësisht të kënaqur. Ndërkohë që 16.2% janë pjesërisht të kënaqur me këtë bashkëpunim.

Pyetja 14 Fryma e bashkëpunimit në departament rezulton me 32.4% plotësisht të kënaqur, 40.5% kënaqur, 21.6% disi të kënaqur dhe 5.4% të pakënaqur.

Pyetja 15-16 Për sa i përket vendim-marrjes në departament, 91.9% mendojnë se departamenti mbledhet rregullisht për vendim-marrje, ndërsa pjesa tjetër shprehen pjesërisht dakord me këtë pohim. Në lidhje me përfshirjen në vendim-marrje, ndërkohë që 83.8% mendojnë se janë të përfshirë në këtë proces, 8.1% mendojnë se janë pjesërisht të përfshirë, dhe 8.1% mendojnë se janë jo të përfshirë ose aspak të përfshirë në vendim-marrje në nivel departamenti.

Si përfundim, mund të thuhet se në institucion promovohet fryma e bashkëpunimit.

C. Politikat dhe menaxhimi i institucionit

Pyetja 17-18 59.4% e pjesëmarrësve mendojnë se menaxhimi dhe drejtimi i institucionit bëhet në mënyrë të denjë, 24.3% e tyre janë pjesërisht dakord me këtë pohim dhe pjesa tjetër nuk janë dakord. Ndërkohë që 54% mendojnë se drejtuesit e institucionit kanë një vizion të qartë për zhvillimin strategjik të institucionit, pjesa tjetër janë pjesërisht dakord (24.3%), jo dakord (13.5%) dhe aspak dakord (8.1%).

Pyetja 19 Për sa i përket përcjelljes së ankesave në organet drejtuese, 64.8% mendojnë se mund ta bëjnë lirisht, 24.3% janë disi dakord, dhe 10.8% nuk janë dakord se përcjellja e ankesave është lehtësisht e realizueshme.

Pyetja 20 40.5% e pjesëmarrësve mendojnë se janë të përfshirë në vendim-marrje në institucion, 45.1% janë pjesërisht dakord dhe 24.3% mendojnë se nuk janë të përfshirë në vendim-marrje.

Pyetja 21 Pyetjes në lidhje me mbështetjen e ideve inovative, 56.7% e stafit shprehen se janë të kënaqur, 35.1% disi të kënaqur, dhe 8.1% mendojnë se mendimet inovative nuk mbështeten sa duhet.

Pyetja 22-23 Ndërkohë që 97.3% e stafit mendon se studentët përbëjnë përparësi për institucionin, vetëm 2.7% shprehen se sipas tyre studentët janë pjesërisht përparësi për institucionin. Edhe për sa u përket marrëdhënieve mes stafit dhe studentëve, 100% e pjesëmarrësve shprehen se ato janë në nivele shumë të mira dhe të mira.

Pyetja 24 Pjesa dërrmuese e stafit (81%) mendon se në institucion nxitet fryma e bashkëpunimit dhe e komunikimit të mirë mes kolegëve, 13.5% janë pjesërisht dakord dhe 5.4% mendojnë se në institucion nuk nxitet fryma e bashkëpunimit dhe komunikimit.

Pyetja 25 48.6% e pjesëmarrësve mendojnë se institucioni ofron mundësi të mjaftueshme për zhvillimin profesional, 43.2% janë pjesërisht dakord dhe 8.1% nuk mendojnë se në institucion ofrohen mundësi të mjaftueshme për nevojat e zhvillimit profesional.

Pyetja 26 Ndërkohë që 62.1% e pjesëmarrësve shprehen se u janë bërë të qarta përgjegjësitë dhe detyrat në lidhje me pozicionin që kanë, 24.3% janë pjesërisht dakord, dhe pjesa tjetër (13.5%) shprehen se nuk u janë bërë të qarta detyrat dhe përgjegjësitë.

Ndërkombëtarizimi

Pyetje 27-29 Për sa i përket ndërkombëtarizimit, 75.6% mendojnë se institucioni i kushton

rëndësi prezantimit kombëtar dhe ndërkombëtar, 21.6% janë pjesërisht dakord dhe 2.7 nuk janë aspak dakord. Në lidhje me promovimin e kërkimit shkencor, më pak se gjysma e pjesëmarrësve (45.9%) mendojnë se institucioni bën mjaftueshëm për nxitjen e kërkimit shkencor, 48.6% janë pjesërisht dakord se në këtë drejtim bëhet mjaftueshëm dhe pjesa tjetër (5.4%) mendojnë se nuk bëhet aspak promovim në këtë drejtim. Si pjesë e rëndësishme e ndërkombëtarizimit, programet e shkëmbimit janë një pikë për të cilën 62.1% e pjesëmarrësve mendojnë se promovohet mjaftueshëm, 32.4% janë pjesërisht dakord se bëhet mjaftueshëm dhe pjesa tjetër 5.4% nuk janë dakord që institucioni i kushton rëndësinë e duhur apo i promovon mjaftueshëm programet e shkëmbimit.

Si përfundim, pak më shumë se gjysma e pjesëmarrësve mendojnë se në përgjithësi menaxhimi dhe drejtimi i institucionit është në nivele të kënaqshme. Pjesëmarrësit mendojnë se duhet më shumë promovim dhe nxitje e ideve inovative.

Për sa i përket ndërkombëtarizimit, edhe pse shumica e pjesëmarrësve janë dakord që institucioni i kushton rëndësi ndërkombëtarizimit, vihet re se në hapa konkretë stafi ka më shumë pritshmëri për përfshirje në programe shkëmbimi, dhe për nxitjen dhe promovimin e kërkimit shkencor.

D. Ngarkesa dhe vlerësimi i punës

Pyetja 30 Pyetja në lidhje me ngarkesën nxjerr në pah se 51.3% mendojnë se ngarkesa e tyre është e pranueshme, 32.4% mendojnë se ajo është pjesërisht e përbalueshme dhe 16.2% mendojnë se ngarkesa e tyre në punë nuk është e pranueshme.

Pyetja 31 Në lidhje me vlerësimin për punën që bëjnë, 45.9% ndihen të vlerësuar, 32.4% disi të vlerësuar dhe 21% nuk ndihen të vlerësuar për punën që bëjnë.

Pyetja 32 Në total, 78.3% e pjesëmarrësve janë të kënaqur që punojnë në KU Bedër, dhe vetëm 18.9 % janë disi të kënaqur për këtë, vetëm 2.7% e pjesëmarrësve shprehen të pakënaqur që punojnë në Kolegjin Universitar “Bedër”.

Si përfundim, mund të thuhet se 2/3 e stafit mendojnë se kanë ngarkesë të përbalueshme dhe rreth 1/3 e stafit akademik pjesëmarrës në anketë mendon se kanë mbingarkesë në punë. Për sa i përket vlerësimit në punë dhe kënaqësinë e të qenit pjesë e institucionit, 45.9% ndihen të vlerësuar dhe 78.3% janë të kënaqur që punojnë në Bedër.

E. Sugjerimet dhe komentet e stafit akademik

Sugjerimet apo komentet që pjesëmarrësit në anketë kanë shprehur kanë të bëjnë me pikat si më poshtë:

1. Rekrutimi i stafit akademik cilësor
2. Paga e stafit akademik në nivele më të kënaqshme
3. Investimi ne rritjen e prezences në platforma sociale
4. Rritja dhe përmirësimi i infrastrukturës teknologjike dhe mbështetëse për studentët dhe stafin
5. Mundësia e printimit të silabuseve në formatin final në BIS dhe përditësimi i tij
6. Zbatimi në praktikë i politikave dhe procedurave për vlerësimin e performancës së stafit
7. Më shumë trajnime për stafin akademik dhe nxitje e kërkimit shkencor
8. Bashkëpunim të mirë midis stafit administrativ dhe stafit akademik
9. Shtimi i literaturës në bibliotekë
10. Krijimi i një Student Counseling Center aktive

Përfundime

Bazuar në analizën e përgjigjeve, në funksion të përmirësimit të shërbimeve dhe rritjes së cilësisë në institucion, shihen të nevojshme rekomandimet e mëposhtme:

- 1. Analizë e nevojave për literaturë sipas njësive bazë dhe plotësimi i tyre nga njësitië përkatëse.**
- 2. Analizë e teknologjisë aktuale dhe rinovimi apo shtimi i saj sipas nevojave**
- 3. Promovim dhe nxitje më e shtuar dhe më e gjerë e kërkimit shkencor dhe e programeve të shkëmbimit për stafin.**
- 5. Shtimi i trajnimeve për zhvillimin profesional të stafit.**